



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°17/2022

Hagë, 05/05/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Dje, Trupi Gjykes II deklaroi se aktgjykimi në çështjen *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj* do të shpallet të mërkurën, më 18 maj, në orën 10:00. Shpallja e aktgjykimit do të jetë në seancë publike dhe mund të ndiqet në shqip, serbisht ose anglisht përmes transmetimit në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ose fizikisht nga galeria publike e DHSK-së.

Në çështjen kundër z. Thaçi dhe të bashkakuarve, më 29 prill 2022, ZPS-ja dorëzoi një aktakuzë të ndryshuar kundër z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi. Versioni i redaktuar publik i aktakuzës së ndryshuar gjendet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në vijim të dorëzimit të aktakuzës së ndryshuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi paraqitjen e secilit prej të akuzuarve më 10 maj 2022. Gjatë këtyre seancave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të sigurohet që secili prej të akuzuarve i kupton akuzat e ndryshuara kundër tij.

Në çështjen *Pjetër Shala*, më 28 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit për z. Shala. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekzistojnë ende rreziqet që z. Shala të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë krime të tjera.

Në një vendim të nxjerrë më 25 prill 2022, gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese rizgjodhën gjykatësin Vidar Stensland si Kryegjykatës të kësaj Dhome në përputhje me Rregulloren e Punës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°17/2022

Hagë, 05/05/2022

Kushtetuese. Gjykatës Stenslandi u zgjodh për një mandat njëvjeçar duke nisur prej 1 qershorit 2022.

**Pyetje nga gazetarët**  
Nuk pati pyetje

